URDHËR
Nr. 366, datë 31.5.2021

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT, ZHVILLIMIN E PROVIMEVE DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 14, shkronja "d", dhe 20, pika 10, të ligjit nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat",

URDHËROJ:

1. Provimi i kualifikimit për përmbarues gjyqësor privat organizohet për të gjithë ndihmëspërmbaruesit që përmbushin kushtet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "e" dhe "ë", të nenit 16, të ligjit nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat" dhe bazohet në procedura transparente, metoda vlerësimi të drejta dhe të besueshme dhe në një nivel të lartë të njohurive profesionale të ndihmëspërmbaruesve.
2. Provimi i kualifikimit përgatitet nga Komisioni i Kualifikimit, anëtarët e të cilit caktohen nga organet e përcaktuara në nenin 20, pika 3, të ligjit nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", jo më vonë se 3 muaj përpara datës së zhvillimit të provimit të kualifikimit. Kryetar i Komisionit të Kualifikimit është anëtari i caktuar nga Ministria e Drejtësisë.
3. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit, preferencë do të kenë kandidatët që zotërojnë tituj ose grada shkencore ose kanë eksperiencë të provuar shkencore dhe/ose profesionale në çështjet e së drejtës civile.
4. Anëtarët e Komisionit të Kualifikimit gëzojnë integritet të lartë profesional dhe veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në vendimmarrjen e tyre.
5. Komisioni i Kualifikimit mbështetet nga struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë, e cila siguron mbarëvajtjen administrative dhe logjistike të nevojshme për aktivitetet e Komisionit të Kualifikimit.
6. Anëtarët e Komisionit të Kualifikimit marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje nga buxheti i Dhomës, i cili përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës, pas konsultimit me ministrin e Drejtësisë.
7. Ministri i Drejtësisë përcakton me urdhër ditën, orën, vendin e zhvillimit të provimit të kualifikimit, afatet e paraqitjes së kërkesave për shprehje interesi për të hyrë në provim dhe dokumentet përkatëse që duhet të shoqërojnë kërkesën.
8. Njoftimi për organizimin e provimit të kualifikimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë shpallet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe publikohet, për së paku 15 ditë, në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës.
9. Në rast se kërkohet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, nëpunësit e strukturës përgjegjëse për profesionet e lira pranë Ministrisë së Drejtësisë janë të detyruar t'u vënë në dispozicion një kopje të urdhrit të ministrit të Drejtësisë dhe t'i sqarojnë e orientojnë, lidhur me kushtet ligjore që duhen plotësuar dhe afatet përkatëse.
10. Personat e interesuar paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën për shprehje interesi, si dhe dokumentacionin përkatës që vërteton se i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për të marrë pjesë në provim, në përputhje me përcaktimet në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.

11. Struktura përgjegjëse për profesionet e lira në Ministrinë e Drejtësisë organizon punën për regjistrimin e kërkesave të ardhura dhe verifikimin e dokumentacionit shoqërues, si dhe informon të interesuarit lidhur me kushtet e organizimit të provimit.

12. Lista kualifikuese për të marrë pjesë në provim, si dhe lista e të skualifikuarve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës, jo më vonë se 7 ditë para ditës së organizimit të provimit.

13. Personat që janë renditur në listën skualifikuese, kanë të drejtë t'i drejtohen me ankesë Ministrisë së Drejtësisë, brenda 3 ditëve nga dita e publikimit të listave, sipas pikës 12 të këtij urdhri.

14. Pas shqyrtimit të ankesave dhe vënies në dijeni të personave që i kanë paraqitur ato, Ministria e Drejtësisë publikon në faqen zyrtare listën përfundimtare të të kualifikuarve për provim, jo më vonë se 2 ditë para ditës së organizimit të provimit. Lista publikohet edhe në faqen zyrtare të Dhomës.

15. Provimi i kualifikimit përbëhet nga pjesa e kontrollit të njohurive me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë. Kandidatët kanë të drejtë të hyjnë në pjesën e provimit me shkrim deri në 3 herë.

16. Kandidatët paraqiten për të marrë pjesë në kontrollin e njohurive me shkrim në ditën, orën dhe vendin e caktuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.

17. Identifikimi i kandidatëve, mbikëqyrja e tyre deri në dorëzimin e përgjigjeve të tezës dhe përcaktimi i listës emërore të personave që morën pjesë në provim kryhet nga komisioni mbikëqyrës, i cili përbëhet nga të paktën dy përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe dy përfaqësues nga Dhoma.

18. Hyrja për në ambientet e brendshme të zhvillimit të provimit me shkrim do të bëhet 1 (një) orë përpara orarit të njoftuar për provimin.

19. Identifikimi i kandidatëve bëhet në bazë të një dokumenti identifikimi personal të vlefshëm dhe me fotografi, i cili mund të jetë letërnjoftim ose pasaportë.

20. Kandidatët që nuk kanë mjete identifikimi të vlefshme, sipas pikës 19 të këtij urdhri, përjashtohen nga e drejta për të marrë pjesë në provimin me shkrim.

21. Kandidatët ftohen të zënë vendet, sipas një përzgjedhjeje rastësore të caktuar nga anëtarët e Komisionit të Kualifikimit dhe për asnjë arsye nuk mund të ndryshojnë vendin e caktuar. Kandidati nuk lejohet të dalë jashtë, si dhe asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në sallën e provimit, përfshirë këtu edhe kandidatët e kualifikuar për provim, të cilët janë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

22. Pasi është kryer identifikimi i kandidatëve, udhëzohen të deklarojnë dhe të dorëzojnë të gjitha sendet personale ose pajisjet, si çantë, dosje, laps ose stilolaps, mjete elektronike ose telefonike, të cilat nuk lejohen në sallën e provimit, pranë punonjësve të caktuar për këtë qëllim.

23. Kandidatëve u shpërndahet baza materiale e nevojshme për kryerjen e provimit, kopje të parapërgatitura të testit, të cilat kanë në çdo fletë nënshkrimin e kryetarit të Komisionit të Kualifikimit, si dhe fletët për plotësimin e alternativave, të vulosura në pjesën e pasme, të cilat përmbajnë edhe kodin e provimit, që do të jetë një numër me dy ose më tepër shifra dhe unik për çdo kopje të testit dhe për çdo kandidat.

24. Pas shpërndarjes së testit, kandidatëve u kalohet një listë me emrat e tyre dhe secili shënon kodin e testit përbri emrit të vet. Pas përfundimit të shënimit të kodeve nga të gjithë kandidatët, lista mbyllet në një zarf të veçantë, për t'u hapur nga Komisioni i Kualifikimit pas vlerësimit të provimeve.

25. Përpara fillimit të provimit, kandidatët e pranishëm vihen në dijeni:

a) për kohën brenda së cilës duhet të përfundojë dhënia e përgjigjeve, e cila gjendet e përcaktuar në tezën e provimit;

b) udhëzohen që të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë ambientit ku organizohet provimi;

c) udhëzohen të mos shënojnë ose të lënë emrin, të bëjnë shenja sado të vogla, shprehje apo citime në tezën e provimit, të cilat mund ta bëjnë kandidatin të identifikueshëm;

ç) të mbajnë qetësi;

d) të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara;

dh) për mënyrën e komunikimit me anëtarët e Komisionit të Kualifikimit ose të komisionit mbikëqyrës, në rast nevoje, e cila duhet të jetë me zë të ulët dhe duke e thirrur në vendin përkatës nga ku po zhvillojnë provimin;

e) përzgjedhjen e zarfit të tezës me zgjedhje rastësore përpara auditorit;

ë) jepen udhëzime e sqarime të tjera të rastit dhe vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

26. Pyetjet e provimit do t'i referohen legjislacionit që zbatohet në ushtrimin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor, duke synuar testimin e njohurive dhe të aftësive të kandidatëve në fushën e veprimtarisë përmbarimore dhe zgjidhjen e rasteve konkrete.

27. Provimi përbëhet të paktën nga pyetjet në fushën e së drejtës civile, së drejtës procedurale civile, së drejtës publike për aspekte të veçanta, për aq sa lidhen me fushën e përmbarimit gjyqësor, si dhe nga korniza ligjore që rregullon veprimtarinë e përmbarimit gjyqësor privat.

28. Tezat e provimit me shkrim dhe pyetjet e provimit me gojë përgatiten nga Komisioni i Kualifikimit jo më herët se një ditë para datës së organizimit të provimit dhe nuk duhet t'u bëhen të ditura personave të tjerë. Pyetjet e provimit me shkrim hartohen në disa teste të ndryshme, të cilat futen në zarfe të ndryshme, prej të cilave një do të zgjidhet për t'u aplikuar në provim. Zgjedhja do të bëhet me short, ditën që do të organizohet provimi dhe në prani të kandidatëve.

29. Të gjitha zarfet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Kualifikimit. Komisioni i Kualifikimit, ditën e testimit në prani të kandidatëve, përzgjedh me short njërin prej zarfeve. Zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar, në të kundërtën teza në të është e pavlefshme dhe zëvendësohet me një zarf tjetër të mbyllur. Pas përzgjedhjes zarfi hapet dhe teza e përzgjedhur u lexohet publikisht pjesëmarrësve nga Kryetari i Komisionit të Kualifikimit. Në një zarf tjetër të mbyllur ndodhen brenda përgjigjet e testit në dy kopje, i cili hapet kur të përfundojë koha e provimit.

30. Teza e provimit me shkrim përmban vetëm pyetje me alternativa, ku përgjigjet jepen në mënyrë skematike, pa fjalë, sipas teknikës *scan-tron*. Për plotësimin e saj kandidati rrethon saktë vetëm njërën prej tyre në fletën e përgjigjes. Korrigjimi i mëvonshëm apo zgjedhja e më shumë se një prej alternativave për secilën pyetje e bën përgjigjen automatikisht të pasaktë.

31. Gjatë plotësimit të tezës së provimit nuk duhet të përdoren baza të tjera materiale veç atyre të vëna në dispozicion nga Komisioni i Kualifikimit ose komisioni mbikëqyrës.

32. Kandidati, që gjatë provimit nuk i respekton udhëzimet e dhëna sipas këtij urdhri, njoftohet pa paralajmërim të ndërpresë provimin dhe të lërë menjëherë sallën e provimit, duke i komunikuar edhe skualifikimin nga procedura e provimit.

33. Kandidati i skualifikuar barazohet me ata që nuk e kanë marrë minimumin e nevojshëm të pikëve të parashikuara në ligj për t'u kualifikuar. Në këtë rast, përkrah emrit të personit bëhet shënimi "Skualifikohet", vihet në dijeni kryetari i Komisionit të Kualifikimit dhe bëhet pasqyrimi përkatës në procesverbalin e provimit, ku shënohet nxjerrja jashtë procesit të vlerësimit të tezës përkatëse, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e tij.

34. Procesverbali i provimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit mbikëqyrës dhe bëhet pjesë e dosjes mbi procedurat e zhvilluara, duke i bashkëlidhur edhe tezat (fletët e përgjigjeve) të personave të skualifikuar.

35. Pas përfundimit të kohës së caktuar për provim, bëhet mbledhja e përgjigjeve të tezave të kandidatëve, si dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura në provim dhe, nëse është rasti, bëhen shënimet përkatëse sipas parashikimeve të mësipërme.

36. Pasi janë dorëzuar fletët e përgjigjeve për vlerësim automatik, hapet zarfi me përgjigjet e testit dhe një kopje e përgjigjeve administrohet nga Komisioni i Kualifikimit, ndërsa një kopje tjetër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës.

37. Komisioni i Kualifikimit, pasi skanon fletët e përgjigjeve, kryen vlerësim elektronik (me teknikën *scan-tron*) të tyre. Administrimi i rezultateve të përfituara nga korrigjimi automatik dokumentohet me procesverbal nga njëri prej anëtarëve të Komisionit, që zgjidhet nga kryetari.

38. Provimi i kualifikimit vlerësohet me maksimumin e mundshëm 100 pikë, nga të cilat provimi me shkrim përmban 75% të numrit total të pikëve (75 pikë). Ndihmëspërmbaruesi që vlerësohet me të paktën 60% të pikëve në pjesën e provimit me shkrim kalon në kontrollin e njohurive me gojë.

39. Testet e vlerësuara automatikisht nënshkruhen në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Kualifikimit. Rezultatet e përgjigjeve të përfituara nga sistemi elektronik i vlerësimit për çdo test pasqyrohen në një listë, e cila përmban kodin dhe përbri pikët vlerësuese. Lista nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Pas nënshkrimit të listës me kodet dhe pikët e vlerësimit për testet përkatëse, hapet zarfi me emrat dhe kodet e kandidatëve dhe përbri emrit dhe kodit të çdo kandidati shënohen pikët e fituara.

40. Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara nga ndihmëspërmbaruesit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Kualifikimit. Një kopje e saj publikohet brenda ditës në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës. Për efekt ankimi, ky afishim është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

41. Kandidatët që kanë vërejtje për vlerësimin, kanë të drejtë të ankohen brenda 3 ditëve nga dita e afishimit të listës. Komisioni i Kualifikimit shqyrton ankimet jo më vonë se 3 ditë pas kalimit të këtij afati dhe vë në dijeni ankuesin mbi shqyrtimin e ankimit.

42. Provimi me gojë zhvillohet brenda një afati prej 4 javësh pas provimit përkatës me shkrim para Komisionit të Kualifikimit. Provimet me gojë janë të hapura për publikun.

43. Menjëherë pas përfundimit të pjesës së provimit me gojë, anëtarët e Komisionit të Kualifikimit japin vlerësimin e tyre, në lidhje me rezultatet e secilit individ, në konsultime me dyer të mbyllura, duke përllogaritur shumën e pikëve totale të fituara nga kontrolli i njohurive me shkrim dhe me gojë. Anëtarët e komisionit fillimisht votojnë nëse kandidatët e kanë kaluar provimin dhe, nëse po, për vlerësimin me pikë. Anëtarët e Komisionit të Kualifikimit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe votimit në mbledhje.

44. Fitues është individi që ka mbledhur pikët më të larta në provimin e kualifikimit, me kusht që të ketë grumbulluar minimalisht 60% të pikëve maksimale të parashikuara, deri në plotësimin e vendeve vakante, sipas urdhrit të ministrit të Drejtësisë, të parashikuar në ligjin për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat. Në rast se për vendin e fundit kanë fituar të njëjtin numër pikësh më shumë se një kandidat, kandidati fitues përcaktohet me anë të shortit, i cili realizohet në prezencë të kandidatëve me të njëjtin numër pikësh.

45. Gjatë vlerësimit të provimit mbahet procesverbal nga një prej anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit, që zgjidhet nga kryetari. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Kualifikimit, përfshirë edhe ata që nuk pajtohen me vendimin. Anëtari, që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës, e nënshkruan procesverbalin me shënimin: "Nuk pajtohem me vendimin. Bashkëlidhur paraqes mendimin tim.". Anëtari në pakicë paraqet veçmas, me shkrim, mendimin e tij dhe pasi nënshkruhet nga hartuesi, i bashkëlidhet procesverbalit. Në rast se anëtari i Komisionit, i cili ka mendim të kundërt me shumicën, nuk përgatit mendimin e tij me shkrim si më lart, kundërshtimi i tij konsiderohet i paqenë.

46. Ndihmëspërmbaruesit që kanë vërejtje për vlerësimin e Komisionit të Kualifikimit, kanë të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga marrja dijeni për rezultatet e provimit.

47. Pas shqyrtimit të ankimeve, Komisioni i Kualifikimit përgatit listën me emrat dhe pikët e fituara për secilin ndihmëspërmbarues, e cila nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij. Lista i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Kualifikimit.

48. Lista e fituesve shpallet publikisht dhe qëndron e afishuar për 15 ditë në selinë e Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës, si dhe në faqet zyrtare të tyre.

49. Procesverbalet, përgjigjet e tezave, tezat e skualifikuara, si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër që krijohet dhe i përket procesit të organizimit të provimit të kualifikimit, shpalljes së rezultateve dhe

të personave që kalojnë me sukses provimin, ruhen në një dosje të veçantë në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

50. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

51. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)